

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE

“TECH SUR MER” SHPK

Sot me date 13/11/2024,

- ***Massimiliano Stefano Paletti Meloni, atesia Giuseppe, shtetas italian, lindur me 25.08.1976, ne Milano (MI) Itali dhe banues ne Monza (MB), rruga “Jean Sibelius n. 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. CA72298ER.***
- ***Francesca Capaccioli, atesia Massimo, shtetas italian, lindur me 30.04.1991, ne Roma (RM) Itali dhe banues ne Monza (MB), rruga “Jean Sibelius n. 5, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. 4498923AA.***

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tim te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 13/11/2024, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“TECH SUR MER” SHPK

Themeluesit e shoqerise jane:

- ***Massimiliano Stefano Paletti Meloni, atesia Giuseppe, shtetas italian, lindur me 25.08.1976, ne Milano (MI) Itali dhe banues ne Monza (MB), rruga “Jean Sibelius n. 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. CA72298ER.***
- ***Francesca Capaccioli, atesia Massimo, shtetas italian, lindur me 30.04.1991, ne Roma (RM) Itali dhe banues ne Monza (MB), rruga “Jean Sibelius n. 5, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. 4498923AA.***

NENI 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. Reklama, shtypshkrime, botime dhe printime te materialeve te ndryshme sipas formateve dhe metodave ne treg;
2. Krijim dhe realizim te sherbimeve konkruese ne fushen Web Design, designe etj;
3. Realizimi i sherbimeve te marketingut dhe konsulence ne kete fushe;
4. Stampime ne te gjitha formave dhe permasave per perdorim ne mallra, pajisje dhe sende te tjera, prodhimit te adeziveve promocionale dhe informues, si dhe botimin apo prmtimin e cdo produkti tjetër qe kerkon teknologji shtypshkrimi te formave dhe permasave te ndryshme;
5. Printime Dixhitale;
6. Realizim dhe transmetim spote audiovizive;
7. Shërbime këshillimi në fushën e shtypshkrimeve dhe printimeve dixhitale;
8. Prodhim-menaxhim reklamash;
9. Agjensi publicitare;
10. Fushata mediatike si dhe veprimtari dhe sipërmarrje në fushën e publicistikës dhe mjeteve të komunikimit masiv;
11. Bashkëpunim dhe operim me shoqëri vendase dhe të huaja, për operime reciproke si nënkontraktor i operatorëve në fushën e shtypshkrimeve si dhe në aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë;
12. Të operojë në sektorin e telekomunikacionit duke kryer çdo lloj veprimtarie nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të të tretëve me seli në Shqipëri apo në çdo vend tjetër që ka lidhje me Republikën e Shqipërisë, duke respektuar ligjin në fuqi;
13. Të kryejë aktivitete nëpërmjet telefonit të çdo lloji për llogari të vet apo të tretëve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nëpërmjet telefonit, sondazhe, mesazhe promocionale dhe çdo lloj tjetër aktiviteti të lidhur me të pa kufizim;
14. Hapja dhe administrimi i përgjithshëm i Call Center, shërbimeve të të dhënave, data entry;
15. Shërbime Call Center dhe Contact Center për klientë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shërbime marketingu jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet telefonit dhe internetit;
16. Zhvillim fage web dhe aplikacione mobile;
17. Analizimi, zhvillimi, prodhimi dhe mirembajtja e programeve kompjuterike (software) ne dhe per te gjitha platformat dhe sistemet, si dhe ofrimin e sherbimeve mbi programet kompjuterike (software);
18. Ofrimi i sistemeve apo infrastruktures hardware-ike, ofrimi i hostimit te sistemeve dhe te dhenave dhe programeve kompjuterike (software) Analize dhe sherbime konsulence per bizneset;
19. Digital marketing dhe e-commerce Analizim dhe shkence te te dhenave;
20. Siguri kibernetike; Web intelligence; Investigime;
21. Teknologji per siguri.
22. Menaxhimi dhe administrimi i nje Qendre te formimit profesional dhe ofrim te kurseve. Çdo veprimtari tjetër te ngjashëm te lejuar nga legjislacioni shqiptar;

23. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike;
24. Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislaçionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore;
25. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me përsone juridike ose fizike ose me cilën do tjetër shoqëri me të njëjtin objekt veprimtarie brenda ose jashtë vendit.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë deri në një afat të papercaktuar.

Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me vendim të asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISE

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tiranë.

KREU II

KAPITALI

NENI 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqërisë do të jetë 100.000 (nëqind mijë) leke i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është:

Kontributi në kapitalin e shoqërisë zotërohet nga Ortaket në masën :

- ***Massimiliano Stefano Paletti Meloni, atesia Giuseppe, shtetas italian, lindur me 25.08.1976, në Milano (MI) Itali dhe banues në Monza (MB), rruga “Jean Sibelius n. 5”, Itali, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me kartën e identitetit italiane me Nr. CA72298ER, zotëron 50% të kuotave nëpërmjet 1 kuote në vlerën 50,000 leke.***
- ***Francesca Capaccioli, atesia Massimo, shtetas italian, lindur me 30.04.1991, në Roma (RM) Itali dhe banues në Monza (MB), rruga “Jean Sibelius n. 5, Itali, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me kartën e identitetit italiane me Nr. 4498923AA, zotëron 50% të kuotave nëpërmjet 1 kuote në vlerën 50,000 leke.***

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8 ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)

- f. Mbikqyrja e zbatimit të politikave tregetare nga administratorët përfaqësues të pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g. Miratimi, i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogëlim kapitali
- i. Pjestimi i kuotave dhe anulimi i tyre
- j. Përfaqësimi në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë
- l. Miratoni rregulla procedurale të mbledhjeve të asamblese
- m. Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamble të përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nepermjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullisë.

NENI 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ceshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregetarët dhe Shoqëritë tregetare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse kuorumi i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk arrihet, asambleja e përgjithshme, mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- ***Francesca Capaccioli, atesia Massimo, shtetas italian, lindur me 30.04.1991, ne Roma (RM) Itali dhe banues ne Monza (MB), rruga "Jean Sibelius n. 5, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. 4498923AA.***

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe

- e) Raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratorët te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE
NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitetin tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

NENI 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortakët dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me ³/4 e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21
LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".


NENI 22
MOSMARREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

Massimiliano Stefano Paletti Meloni



Francesca Capaccioli

